



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Kuvendi i Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK-së) në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.3 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr.04/L-150, nenit 20, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.3 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës dhe nenit 41, paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, përmes votimit qarkullues nga **data 05 maj** deri më **datën 07 maj 2021**, miraton këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani e punës së Odës së Stomatologëve të Kosovës për periudhën prill 2021 – mars 2022.
- II. Programi i punës i miratuar i bashkangjitet këtij vendimi si shtojcë.
- III. . Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Duke u bazuar në situatë aktuale të pandemisë dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 01/05 të datës 05.04.2021 i cili në pikën 21. ka ndaluar grumbullimin në hapësira të mbyllura për më shumë se 10 persona, në pamundësi për organizim të Kuvendit, në mbështetje të nenit 41 të Ligjit të Procedurës Administrative nr 05/L-03, anëtarëve të Kuvendit të OSK-së i është dërguar

raporti i punës (prill 2020- mars 2021) dhe plani i punës (prill 2021- mars 2022) i OSK-së për miratim me votim qarkullues i cili është zhvilluar nga data 05 maj deri më datën 07 maj 2021. Pas mbylljes së afatit për votim Kuvendi vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kryetari i OSK-së
Prof.Dr. Blerim Kamberi



